



**AAC: PROGRAMI KOMBËTAR
I PRAKTIKAVE TË PUNËS**
Në kuadër të Programit të
Praktikave të Punës, në
Autoritetin e Aviacionit Civil
përgjatë muajve janar-prill 2018...
faqe 2-3



**MAQEDONI: ZHVILLOHET
"SEMINARI I SIGURISË NË
AVIACION I ICAO-S"**
Inspektorët e Drejtorisë së
Sigurisë në AAC, kanë marrë
pjesë në seminarin e zhvilluar
në Shkup...
faqe 8

TETOR 2018 - Botimi VI

posta ajrore



Buletini mujor i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar

www.aac.gov.al | info@acaa.gov.al

Tel: +355 4 22 51 220



ANALIZË
VIOLETA BULC
KOMISIONERJA E KE
PËR TRANSPORTIN:
MË SHUMË PËR
KOORDINIMIN E ANSP

faqe 7

STATISTIKA
GUSHT 2018, FLUKS NË
RRITJE I PASAGJERËVE

Ky muaj karakterizohet nga
një fluks në rritje i pasagjerëve.
Shifrat referojnë një numër prej
376,290 pasagjerë të cilët kanë
udhëtuar gjatë kësaj periudhe...

faqe 5

VONESA & ANULLIME
MUJJI SHTATOR
PROBLEMATIK

Shtatori ka vijuar të jetë
problematik në lidhje me vonesat
e fluturimeve me destinacion
disa qytete të Italisë. Nga të
dhënat zyrtare rezulton, se
kompania me numrin më të lartë
të vonesave mbi 2-3 orë është
Blue Panorama, me 19 të tilla...



REKORD I FLUTURIMEVE CHARTER KORRIK-GUSHT 2018

**REFERUAR TË DHËNAVE ZYRTARE TË ARDHURA NË AUTORITETIN E
AVIACIONIT CIVIL NGA AEROPORTI NDËRKOMBËTAR "NËNË TEREZA"...**

faqe 4

PROGRAMI I PRAKTIKAVE TË PUNËS

INTERVISTA ME STUDENTËT E EKSELENCËS

Në kuadër të Programit të Praktikave të Punës, në Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar përgjatë muajve janar-prill 2018 të rinj të sapo diplomuar zhvilluan një praktikë pune në sektorë të ndryshëm të AAC si: Sektori i Sigurisë në Aviacion, Sektori i Mbikqyrjes Operacional, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, Sektori i Certifikimit, Master Planeve, Mjedisit dhe Cilësisë së Shërbimit, Sektori i të Drejtave të Pasagjerëve. Qëllim i Praktikave të Punës ishte njohja me administratën publike dhe kryesisht njohja me industrinë e aviacionit. Më poshtë do të njiheni me intervistat e disa prej tyre me përshtypjet për AAC-n.



Samanda Sulaj

Msc. Inxhinieri Telekomunikacioni

SI JU DUKET “PROGRAMI I PRAKTIKAVE TË PUNËS”?

Të gjithë e dimë sa e vështirë është përballja me tregun e punës pas përfundimit të studimeve. Mundësitë që të ofron tregu janë të pakta sidomos kur nuk ke fare eksperiencë, për rrjedhojë mundësia që na u ofrua nëpërmjet këtij programi është një ndihmë e madhe për të përfutur përvojë dhe për t'u njohur nga afër me punën në administratën publike. Për këto arsye e vlerësoj mundësinë që na u dha për të qenë pjesë e këtij programi dhe shpresoj që ky program të vazhdojë sa më gjatë duke ju ardhur në ndihmë studentëve të sapo diplomuar çdo vit.

SI JU DUKET EKSPERIENCA NË AVIACION DHE CILIN SEKTOR MBULONI?

Në përputhje me profilin tim si Inxhinieri Telekomunikacioni jam pozicionuar si Asistente Specialiste pranë Drejtorisë së Mbikqyrjes Shërbimeve të Lundrimit Ajror. Kjo drejtori mbikqyr Ofruesin e vetëm të shërbimit të lundrimit ajror në Shqipëri, ALBCONTROL Sh.a. Drejtorja është e organizuar në 3 sektorë, Sektori i mbikqyrjes operationale, Sektori i mbikqyrjes teknike dhe Sektori mbikqyrjes së personelit. Aviacioni gjithmonë ka qenë në prioritetet e mia dhe për këtë arsye aplikova që praktikën ta ndiqja pranë AAC që është institucioni rregullator dhe mbikqyrës më i lartë në vend. Deri tani eksperiencia ka qenë shumë pozitive duke më dhënë mundësinë të njihem nga afër me proceset e punës dhe sfidat që ka kjo fushë. Falë suportit të vazhdueshëm nga kolegët e DMSHLA kam arritur të integrohem pjesërisht dhe të zgjeroj njohuritë në këtë fushë.


SI E MENDONI KARRIERËN TUAJ DHE E SHIKONI TË ARDHMEN TUJ NË AVIACION?

Që në fillimet e studimeve kam qenë e qartë në dëshirën time për të qenë pjesë e industrisë së aviacionit dhe ofrimi i kësaj mundësie nga Programi i Praktikave të Punës e realizoi këtë dëshirë. Në AAC kam gjetur një frymë bashkëpunimi dhe një ambjent inspirues për të vazhduar dhe në të ardhmen karrierën në këtë fushë. Meritë të veçantë ka Drejtori Ekzekutiv i AAC, z. Krislen Keri i cili ka shprehur mbështetjen e vazhdueshme për të gjithë të rinjtë që kanë dëshirën dhe vullnetin për të qenë pjesë e botës së aviacionit.



Panajot Shaho

Ba. Ekonomi Ndërmarrje



SI JU DUKET “PROGRAMI I PRAKTIKAVE TË PUNËS”?

Pasi mbarova studimet e larta për “Ekonomi Ndërmarrje” në Universitetin “Zoja e Këshillit të Mirë”, dëgjova për mundësinë e shkëlqyer të “Programit të Praktikave të Punës”, dhe mendova se kjo mund të ishte një mundësi e mirë për të gjithë të sapo diplomuarit që duan të marrin eksperiencë profesionale në administratën shtetërore ndaj dhe aplikova duke u bërë pjesë e tij. Ky program më dha mundësinë të punoj në Autoritetin e Aviacionit Civil, ndaj për mua është një nga programet më të vlefshëm për të rinj që duan të jenë pjesë e tregut të punës.

SI JU DUKET EKSPERIENCA NË AVIACION DHE CILIN SEKTOR MBULONI?

Për mua është një eksperiencë totalisht e re dhe e veçantë që më bën të interesohem dhe të kem dëshirën për të mësuar sa më shumë gjëra të reja rreth aviacionit. Jam emëruar Asistent Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve të Përgjithshme (DSHP) në Sektorin e Kontratave dhe Shërbimeve. Një mundësi shumë e mirë për mua për të kuptuar procedurat administrative të prokurimeve.

SI E MENDONI KARRIERËN TUAJ DHE E SHIKONI TË ARDHMEN TUJ NË AVIACION?

Çdo ditë pune në Autoritetin e Aviacionit Civil, bëhet më interesante sepse ka plot gjëra të reja për të mësuar dhe kjo të inspiron drejt një karriere po në këtë fushë, ndaj dua të jem pjesë e këtij institucioni që po zhvillohet çdo ditë, falë përkushtimit të Drejtorit Ekzekutiv, z. Krislen Keri dhe stafit të tij bashkëpunues. Ky është një motiv më shumë për të menduar për të ardhmen time në aviacion.



Enxhelina Harizi

Msc. Inxhineri Mekanike

SI JU DUKET “PROGRAMI I PRAKTIKAVE TË PUNËS”?

Pasi mbarova studimet në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike (UPT), aplikova në “Programin e Praktikave të Punës”, ku mu dha mundësia për t’u njohur me administratën publike. Për çdo të ri të sapodiplomuar, internship janë një mundësi shumë e mirë për të ballafaquar njohuritë e marra në shkollë me praktikën dhe marrjen e eksperiencave të reja.

SI JU DUKET EKSPERIENCA NË AVIACION DHE CILIN SEKTOR MBULONI?

Falë këtij programi përfitova një kontratë një vjeçare në AAC. E punësuar në Drejtorinë e Aeroporteve - Sektorin e Certifikimit, Master planeve, Mjedisit, Cilësisë së shërbimit, eksperiencën në aviacion më duket sa e vështirë aq dhe e bukur. E vështirë sepse përballesh menjohuri dhe praktikat e reja dhe e bukur sepse aviacioni është një fushë intriguese.

SI E MENDONI KARRIERËN TUAJ DHE E SHIKONI TË ARDHMEN TUAJ NË AVIACION?


Ndihem e vlerësuar dhe e motivuar për të vazhduar më tej në fushën e aviacionit, falë mbështetjes dhe suportit të Drejtorit Ekzekutiv, Z. Krislen Keri dhe stafit të AAC-së. Do të dëshiroja shumë që të më jepej mundësia të vazhdoja karrierën time në aviacion, pasi aviacioni është një nga fushat më të zhvilluara në ditët e sotme dhe me perspektivë për të ardhmen.



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Jonik Hoxha

Msc. Menaxhim Ekzekutiv



SI JU DUKET “PROGRAMI I PRAKTIKAVE TË PUNËS”?

Për mendimin tim është një mundësi shumë e mirë për të rinjtë që të mësohen me njohjen e proceseve të punës gjithashtu duke ndikuar pozitivisht në formimin profesional. Gjithashtu mund të them se edhe ndarja sipas sektorëve përkatës në institucion sipas profilit të duhur arsimor të secilit është produktive për të dyja palët.

SI JU DUKET EKSPERIENCA NË AVIACION DHE CILIN SEKTOR MBULONI?

Të jem i angazhuar në industrinë e aviacionit ka qënë gjithmone ide intriguese dhe një dëshirë e kahershme e imja, për të cilin shpjegimi logjik i parë që më vjen ndërmend, është fakti i të kaluarit të një fëmijërie në një ambient ku gjyshi dhe më pas babai investuan të gjithë rininë e tyre duke bërë karrierë në Aviacionin Civil Shqiptar dhe ku në çdo tryeze apo drekë familjare, diskutimi mbi konceptet dhe sfidat e aviacionit ishin pjesë e tyre. Aktualisht jam caktuar si Asistent Specialist në Sektorin e Mbikqyrjes Operacionale në Drejtorinë e Mbikqyrjes së Shërbimit të Lundrimit Ajror, pozicioni i cili të krijon mundësinë e familjarizimit me konceptet dhe shërbimet e Menaxhimit të Trafikut Ajror.

SI E MENDONI KARRIERËN TUAJ DHE E SHIKONI TË ARDHMEN TUAJ NË AVIACION?


Transporti ajror në Shqipëri është në fazën më të vullshme të zhvillimit dhe modernizimit të tij duke qënë në përputhje të vazhdueshme me kërkesat dhe standartet Ndërkombëtare të Aviacionit Civil. E thënë ndryshe, është një nga fushat ku hapësirat dhe mundësitë sidomos për të rinjtë nuk do të mungojnë, ndaj padyshim që do të isha mëse i lumtur të jem pjesë e kësaj industrie, ndaj dhe duke përfituar nga rasti nxis të rinjtë e të rejtat si unë të aplikojnë, për t’ju bashkuar këtij ekipi të mrekullueshëm profesionistësh në Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar.

ANALIZA STATISTIKORE


LINJAT CHARTER REKORD NË MUAJIN KORRIK- GUSHT

■ **GUSHT 2018:** Referuar të dhënave zyrtare të ardhura në Autoritetin e Aviacionit Civil, muaji Gusht 2018 karakterizohet nga një fluks në rritje të pasagjerëve. Shifrat referojnë një numër prej **376,290** pasagjerë të cilët kanë udhëtuar gjatë kësaj periudhe nga të cilët 80,543 pasagjerë kanë udhëtuar me linja Charter.

Në tabelën në të djathtë paraqitet numri i pasagjerëve në total për muajin Gusht 2018



■ **PËRQINDJET:** Referuar të dhënave zyrtare, mbizotëruese në treg për këtë muaj janë fluturimet Charter të cilat zotërojnë 21% të tregut duke mbuluar kështu fluksin më të madh të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Gusht 2018, me një numër prej 80,543 pasagjerë. Ndjekur nga "Blue Panorama" me një numër prej 65,215 pasagjerë ose 17% ndaj totalit, "Ernest s.p.a" me 41,639 pasagjerë dhe 11% ndaj totalit, "Albawings" me 40,092 pasagjerë ose 11% të totalit dhe Alitalia 26,118 pasagjerë ose 7% të totalit mujor. Nisur nga këto të dhëna duke përjashtuar fluturimet Charter, Italia vazhdon të zotërojë përqindjen më të madhe të tregut të transportit ajror për muajin Gusht 2018, duke zënë 46% të totalit, ndjekur nga Turqia me 10%.



Grafiku 1:


Lëvizja e pasagjerëve e ndarë në % sipas operatorëve ajrorë, që kanë udhëtuar për/nga TIA gjatë muajit Gusht 2018.

NUMRI I PASAGJERËVE

■ **CHARTER:** Për sa i përket ndryshimeve të fluksit të lëvizjes së pasagjerëve që udhëtojnë me fluturime Charter në Gusht të 2018 shifrat referojnë në një numër prej 80,543 i cili krahasimisht me vitin 2017 ka pasur një rritje prej 40% dhe nga viti 2016 në vitin 2017 ka shënuar një rritje prej 24.80% të fluksit të pasagjerëve. Sipas të dhënave në tabelën në të djathtë, vëmë re se numri i pasagjerëve që fluturojnë me Charter ka pësuar gjithashtu rritje ndaj totalit të pasagjerëve. Në vitin 2018 është më e dukshme rritja pasi ato përbëjnë 21% ndaj totalit, ndërkohë që në 2017 dhe 2016 ka qenë 18%.

■ **GUSHT 2018:** Nëse referuar shifrave do të analizonim ecurinë e tregut të transportit ajror në vendin tonë për muajin Gusht të viteve 2016-2017-2018, vëmë re se kemi një tendencë në rritje të tregut të pasagjerëve që udhëtojnë nëpërmjet ajrit, vit pas viti.

PASAGJERË GUSHT 2016-2017-2018




Grafiku 2:

Numri i pasagjerëve për fluturimet Charter si dhe në total për muajin Gusht përgjatë 3 viteve të fundit



■ **OPERATORËT AJRORË:** Më poshtë paraqiten të dhënat mbi operatorët ajrorë, përsa i përket rritjes/rënies së fluksit të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Gusht në vitet 2016-2017-2018.



Grafiku 3:

Lëvizja e pasagjerëve që kanë udhëtuar për/nga TIA gjatë muajit Gusht 2018 sipas operatorëve ajrorë.

RAPORTI I PERFORMANCËS

VONESAT: MUAJI SHTATOR

Shtatori ka vijuar të jetë problematik në lidhje me vonesat e fluturimeve me destinacion disa qytete të Italisë. Nga të dhënat zyrtare rezulton, se kompania me numrin më të lartë të vonesave mbi 2 orë është "Blue Panorama" me 19 të tilla. Rritje ka shënuar edhe kompania "Albawings" me 10 të tilla. Kompanitë i kanë arsyetuar vonesat me problemet operationale dhe teknike. Ulje të numrit të vonesave dhe anulimeve ka shënuar kompania "Ernest Spa". Ndërsa kompanitë e tjera, kanë normalizuar operacionet e tyre duke mos shënuar problematika në vonesa dhe anulime.

Në tabelën në të djathtë paraqiten edhe numrat e saktë me vonesa dhe anulime të fluturimeve gjatë muajit Shtator 2018.

	KOMPANIA		KORRIK	GUSHT	DERI 28 SHTATOR
1	BLUE PANORAMA	Vonesa mbi 2 orë	26	3	19
		Anulime	6		
2	ALBAWINGS	Vonesa mbi 2 orë	5	7	10
		Anulime	1		
3	ERNEST	Vonesa mbi 2 orë	1	19	5
		Anulime	2	6	1
4	PEGASUS	Vonesa mbi 2 orë	1		1
		Anulime			
5	ADRIA	Vonesa mbi 2 orë			
		Anulime			
6	AIR SERBIA	Vonesa mbi 2 orë		1	
		Anulime			
7	AUSTRIAN	Vonesa mbi 2 orë	1		
		Anulime			
8	LUFTHANSA	Vonesa mbi 2 orë	1	2	
		Anulime	2		
9	TURKISH	Vonesa mbi 2 orë			
		Anulime			
10	WIZZ AIR	Vonesa mbi 2 orë	2	1	
		Anulime			
11	ALITALIA	Vonesa mbi 2 orë	2		
		Anulime		1	

Tabela përkatëse

UDHËZUESI ONLINE PËR TË DREJTAT E PASAGJERIT

Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar, synon që me anë të këtij udhëzuesi të informojë pasagjerët që zgjedhin transportin ajror, të njihen me të drejtat e tyre në rast se kompania ajrore vonohet në nisje mbi 3 orë, anulon fluturimin, apo probleme të tjera që mund të hasen gjatë udhëtimit.

Në linkun e mëposhtëm në faqen zyrtare të internetit të AAC, ju mund të gjeni çdo informacion të detajuar, si dhe formularët përkatës të ankimit:



www.aac.gov.al/te-drejtat-e-pasagjerit



SEKTORI PËR TË DREJTAT E PASAGJERIT



+355 42 381 959 / +355 44 539 959



pax@acaa.gov.al



www.acaa.gov.al

KOMISIONERJA E KE PËR TRANSPORTIN, VIOLETA BULC: MË SHUMË PËR KOORDINIMIN E “ANSP”

Eurokomisionerja për Transportin Violeta Bulc, ka kritikuar shtetet anëtare të Bashkimit European se nuk kanë bërë sa duhet për të ulur numrin e vonesave për shkak të kushteve atmosferike të këqija. Kritikën e saj i shpreh në veçanti për mungesën e bashkëpunimit për projektin “Një Qiell i Përbashkët European”, ndërsa lavdëroi ANSP (ofruesit e shërbimeve navigacionale ajrore kombëtare) të Austrisë, Gjermanisë, Italisë dhe Zvicrës, të cilët kanë një bashkëpunim shumë të mirë, duke sjellë menaxhimin e mirë të trafikut ajror në Alpe, pavarësisht kushteve të vështira të motit. Partnerët paraqitën procedurat e reja, me qëllim uljen e vonesave për shkak të motit në Aeroportin e Mynihut në Gjermani, duke evituar fluksin në zonën ajrore të Karlsruhes UAC dhe rritur procedurat e sigurisë në kushte të vështira klimatike. Nga të dhënat numri i stuhive në Alpe është rritur nga viti i kaluar, ndërsa këtë vit në aeroportin e Mynihut si pasojë e motit ka patur vonesa në 17 ditë krahasuar me 16 të tilla, gjatë vitit 2017. Në shumë raste moti ka ndryshuar brenda një kohe të shkurtër duke bërë që kontrollorët të devijojnë fluturimet në ardhje nga zona e Karlsruhes. Falë procedurave të reja, kontrollorët e Padovës, Vienës apo Zyrihut do të shpërndajnë trafikun në 3 rrugë të tjera ajrore, të kontrolluara nga Karlsruhe, Zyrihu dhe Viena për të garantuar fluturime sa më të qeta drejt Aeroportit të Mynihut. Moti i keq vijon të



Në foto:
Komisionerja e KE për Transportin, Violeta Bulc

jetë një problem i madh për vendet përreth Alpeve, dhe sipas Eurocontrol shkakton vonesa në 1/3 e fluturimeve. Muajin e kaluar menaxherët e rrjetit të Eurocontrol, u mbledhën me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe përmirësimin e situatës në rastet ku nuk është në lartësinë e nevojshme. Joe Sultana drejtori i Menaxhimit të Rrjetit tha se duhet mësuar nga shembulli

amerikan në këtë aspekt që është më i mirë-organizuar, ndërsa Europa mbetet pas, për shkak se fenomenet natyrore nuk janë një problem madhor. Ekspertët thonë se shtetet anëtare të BE-së duhet të punojnë më shumë në forcimin e bashkëpunimit për të përballuar më mirë sfidat e aviacionit.



Në foto:
avion duke fluturuar mbi Alpe

AKTIVITETE TË DREJTORIVE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL GJATË MUAJIT SHTATOR

SIGURIA NË AVIACION

Përgjatë muajit Shtator inspektorët e Drejtorisë së Sigurisë në AAC, kanë marrë pjesë në trajnimin "ICAO Aviation Security Seminar" zhvilluar në Maqedoni në datat 12-14 Shtator 2018. Në këtë trajnim pati pjesëmarrje nga i gjithë rajoni në mbledhjen e gjashtë të Sigurisë në Aviacion organizuar nga Zyra rajonale e ICAO-s. Ky seminar pati pjesëmarrje nga ekspertë të sigurisë, përfaqësues nga shtetet anëtare dhe industria për të kuptuar më shumë mbi implementimin e Aneksit 17, si dhe aspekte të ndryshme lidhur me sigurinë për sa i përket Amendimeve 15,16 të këtij Aneksi. Gjithashtu u shkëmbyen mendime rreth Planit të Sigurisë për Aviacionin Civil Global (GASeP). Një vëmendje e veçantë iu kushtua dokumenteve strategjike në fushën e sigurisë, të diskutuara



në mbledhjen e Drejtorëve të Përgjithshëm mbajtur në Portugali gjatë muajit Gusht 2018. Disa nga temat e tjera që u trajtuan:

- fundit udhëzuese
- Aneksi 17, bashkë me amendimet
- GASeP
- Java e Sigurisë, që do zhvillohet në ICAO.

PROGRAMI I AUDITIT Si një nga prioritetet e vendosur nga Drejtori Ekzekutiv i AAC-së, rëndësi i është dhënë programit të ICAO-s përmes programit USOAP (Universal Safety Oversight Audit Programme). ICAO ndërmerr audite nën kornizën e këtij programi përmbi një dekadë tashmë. Rezultatet e këtyre auditeve lejojnë që ICAO të vlerësojë vendet anëtare mbi kapacitetet në mbikëqyrjen e parrezikshmërisë si dhe për të gjeneruar analiza të

detajuar mbi parrezikshmërinë në aviacion përfshirë implementimin në vendet anëtare. Përmes "Programit USOAP CMA" është një mjet me anë të së cilit shtetet japin informacion të vazhdueshëm dhe janë objekt i auditeve përmes një procesi të vazhdueshëm të mbledhjes së informacionit lidhur me parrezikshmërinë. Ky program jep një pasqyrë të implementimit efektiv të standardeve ndërkombëtare të shtetit.

Gjithashtu në këtë kuadër në datat 11-13 Shtator 2018 u mbajt në Paris, Francë workshop-i i radhës referuar programit ku mori pjesë zëvendës koordinatori kombëtar (NCMC). Shtetet raportuan mbi zhvillimet dhe problematikat e tyre referuar programit si dhe u njohën me ndryshimet më të reja në program nga krijuesit e programit. Në këtë workshop Shqipëria raportoi mbi veprimtarinë e saj.

AAC TAKIM ME ASISTENCËN TEKNIKE TË ICAO-S

Përgjatë këtij workshop-i organizuar në zyrat e AAC-së ekspertët shkëmbyen praktika të mira në lidhje me programin, implementimin efektiv dhe objektivat e vendosura. Diskutimet mes ekspertëve përfshijnë trajtimin e kategorive të:

1. Legjislacionit primar
2. Strukturës së Aviacionit Civil
3. Aktivitetet referuar licensimit të personelit

4. Operimet
 5. Vlefshmëria Ajrore
 6. Aerodromet
 7. Shërbimet e Navigimit Ajror
 8. Investigimi i Aksident Incidenteve
- Ky aktivitet shërbeu si një platformë rajonale e shkëmbimit të eksperiencave të mira drejt një përfaqësimi dinjitoz në respektim të standardeve ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil.



Aviacioni në Botë



SUEDIA SHTON KONTROLLET NË AEROPORTE

Qeveria Suedeze ka vendosur të shtojë kontrollet në 5 aeroportet ndërkombëtare dhe në pika të tjera kufitare si pjesë e masave për të ndaluar emigrimin e paligjshëm. Zyrtarët e policisë vendase, thanë se kanë shtuar personelin e policisë dhe pas masave të marra do të kryejnë më shumë kontrolle, sidomos personave që vijnë nga vendet jashtë Bashkimit Europian, për të parandaluar azilkërkuesit ekonomikë. Masat të forta dhe kontrolle shtesë aplikohen edhe në portet detare të vendit, që përdoren shpesh nga emigrantët. Ata kërkojnë nga udhëtarët që të jenë bashkëpunues dhe mos të shqetësohen nga prania e shumë agjentëve të policisë.



SHBA DENVER 6,1 MILION PASAGJERË NË MUAJ

Drejtimesit e Aeroportit të Denver në Kolorado të SHBA, thanë se muaji Korrik ishte dhe muaji me numrin rekord të pasagjerëve me një numër që shkoi në 6.1 milion pasagjerë, duke shënuar një shifër tejet të lartë për aviacionin. CEO i aeroportit tha se kjo shifër erdhi për shkak të numrit të madh të pasagjerëve të huaj, të cilët kishin destinacione të tjera të rëndësishme, si Zyrihun, dhe në veçanti fluturimet direkte. Gjithashtu



përveçse muajit me më shumë pasagjerë Korriku ishte dhe muaji më një numër rekord pasagjerësh ditorë, ku vetëm në datën 13 Korrik shifra e regjistruar shkoi në 207 mijë pasagjerë. Zyrtarët e aeroportit thanë se rritja nga viti i kaluar është me 21% si dhe falenderuan stafin për përballimin e këtij fluksi kaq të lartë, pa shënuar asnjë incident madhor.

SHBA GATI PËRDORIMI I BIOKARBURANTEVE



Disa nga kompanitë më të mëdha ajrore, janë duke testuar biokarburantet me qëllim futjen e tyre në përdorim nga avionët për të ulur emetimin e gazrave në atmosferë. Shumë prej këtyre kompanive janë optimiste se mund të fusin në përdorim masiv biokarburantet deri në vitin 2020, duke parë edhe parashikimet për rritje të kërkesës për fluturime. Nga statistikave avionët janë përgjegjës për rreth 2% të emetimit të gazrave në nivel global, por duke parë parashikimet për rritje edhe më të madhe në të ardhmen e transportit ajror, emetimi i gazrave po kthehet në një çështje shqetësuese për rregullatorët. Përfaqësuesi i kompanisë United, tha se futja në përdorim e biokarburanteve në aviacion është një evolucion i domosdoshëm për kohën ku po jetojmë. Kjo kompani investoi rreth 30 ml \$, në një impiant që merr mbetjet shtëpiake dhe pas një procesi jo shumë të komplikuar i kthen në biokarburant, duke ulur ndjeshëm emetimin e gazrave. IATA ka vendosur si objektiv ndaj kompanive ajrore që të ulin

emetimin e gazrave më të paktën 50% deri në 2050.

KOMPANIA QATAR AIRWAYS REGJISTRON 69 ML \$ HUMBJE Kompania e njohur Qatar Airways ka akuzuar shtetet që i kanë vendosur bllokadë për shifrat e ulëta të regjistruara deri më tani, që shkojnë deri në 69 milion dollar humbje.



Autoritetet kanë deklaruar se viti 2018, është më sfiduesi në 20 vitet e fundit. Kompania falë operimeve cargo ka arritur të ketë rritje në këtë aspekt me 7,22%. Që nga vendosja e bllokadës në Qershor të vitit 2017, kompania ka regjistruar 19% rënie të prenotimit të biletave. Nga bllokada kompania humbi 18 destinacione të qëndrueshme, por i zëvendësoi ato me 14 të reja, si në Pragë, Kiev apo në Ukrainë. Por pavarësisht kësaj situatë të krijuar si pasojë e problemeve të fundit, kompania mbetet ndër më të fortat me një xhiro vjetore që shkon në 3,6 mld \$ në vit.

AEROPORTI I MILANOS, LINATE



Aeroporti i Milanos është kthyer në një pasarelë ndërkombëtare mode, pasi firma e njohur Emporio Armani, ka vendosur që të prezantoj koleksionin e ri të veshjeve në pistën e Milano Linate. Nata u bë vërtet magjike pas performimit edhe të këngëtarit të njohur Robie Williams. Prej kohësh aeroportet kërkojnë nga kompani të njohura për të zhvilluar edhe aktivitete rekreative që i shërbejnë edhe një publiku të gjerë dhe jo vetëm pasagjerëve.